



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1310/1 Prot.

Tiranë, më 15/10/ 2021

V E N D I M

Nr. 200 , Datë 15 /10/ 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr.167 Regj, datë 17.09.2021, paraqitur nga ankuesi B.V kundër Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komitetit Teknik të Ekspertëve dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave, me pretendimin për diskriminim për shkak të *gjendjes shëndetësore dhe çdo shkak tjetër*. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi B.V, parashtron se, që nga momenti kur virusi Covid-19 filloi të përhapej nga Kina në Europë dhe më pas në Shqipëri, masat shtrënguese të marra nga Qeveria Shqiptare, kanë qenë diskriminuese dhe në shkelje të të drejtave të njeriut. Ankuesi shprehet se, ai dhe çdo qytetar Shqiptar janë konsideruar si të infektuar duke i'u mohuar e drejta për të lëvizur të lirë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke i'u mohuar e drejta për të hyrë në ambientet e administratës publike apo banka dhe dyqane, për të marrë shërbime jetësore pa mbuluar fytyrën me maskë. Ankuesi pretendon se, tani i mohohet e drejta e vazhimit të studimeve të nivelit master, pasi Qeveria Shqiptare ka nxjerrë udhëzim për vaksinim të detyruar për të gjithë studentët apo pedagogët.

Ankuesi pretendon se përderisa ai nuk është klinikisht i diagnostifikuar me virusin, nuk ka pse t'i mohohet e drejta e studimit. Masat shtrënguese që Qeveria Shqiptare po shton dita ditës, sipas ankuesit bien në kundërshtim me të drejtat e njeriut, pasi ai nuk mund të fusë në gjakun e tij një

¹Në vijim do t'i referohemi me shkurtësën Komisioneri.

substancë të panjohur, të patestuar dhe që askush nuk mban përgjegjësi ligjore për efektet e mundshme anësore. Diskriminimi me bazë aludimet e mundshme se ai mund të jetë i infektuar, janë sot në çdo shërbim dhe në çdo fushë të jetës, gjë që rrit tensionet dhe shkakton situata konfliktuale mes tij dhe palëve.

Termi “pasaportë vaksinimi”, e shqetëson ankuesin, pasi sipas tij, ai njeh vetëm pasaportën që i jep Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, atë të shtetësisë shqiptare dhe se çdo imitim apo mutacion politik, është një shtypje e të drejtave dhe lirive qytetare shqiptare.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri që të mbrojë të gjitha kategoritë e njerëzve të diskriminuar për arsye shëndetësore (vaksinuar/të pavaksinuar). Sipas ankuesit, statusi shëndetësor i çdo qytetari duhet të jetë i njohur vetëm nga vetë personi dhe mjeku.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ankesa kishte mangësi të anës formale, në lidhje me tregimin e fakteve, rrethanave dhe dokumentave apo mjeteve të tjera provuese mbi të cilat mbështetej ankesa, nuk identifikohet legjitimitimi aktiv i ankuesit, legjitimitimi pasiv i subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa.

Me qëllim orientimin për plotësimin e të metave, nëpërmjet *email*-it të datës 20.09.2021, ankuesit i'u kërkuar ndër të tjera, që brenda datës 24.09.2021, të plotësonin informacionin në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë, në lidhje me çështjet e mëposhtme:

1. Kopje e një dokumenti që vërteton faktin se ankuesi është student dhe ndjek studimet e nivelit master, sikunder është parashtruar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit.
2. Kopje ose refencën e udhëzimit/udhëzimeve ose aktit/akteve, të cilin/cilët kundërshtohen nga ankuesi pranë Komisionerit, si akt/e diskriminues/e, mbi bazën e të cilit/cilëve, pretendohet cenimi i të drejtës për ndjekjen e studimeve.
3. Saktësimin e subjektit kundër të cilit drejtohet ankesa në lidhje me subjektin “Qeveria Shqiptare”.
4. Meqënëse ankesa drejtohet kundër disa subjekteve, ankuesit i'u kërkuar të jepte shpjegime në lidhje me veprimet apo mosveprimet konkrete, të konsumuara nga ana secilit prej këtyre subjekteve, të cilat nga ankuesi konsiderohen si veprime që kanë cenuar të drejtën e tij për arsim. Pra, cilat janë aktet/udhëzimet/komunikimet/sjelljet e këtyre subjekteve, që kanë sjellë mohimin e të drejtës.

Me *e-mail* datë 27.09.2021, ankuesi ka kthyer përgjigje duke parashtruar, ndër të tjera se, ankesa e tij nuk ka të bëjë vetëm me të drejtën e arsimimit, por me të gjitha të drejtat që një qytetarë i lirë ka. E drejta e arsimimit, lëvizjes së lirë, aksesit ndaj shërbimeve sociale, mjeksore, institucionale, e drejta e zgjedhjes për injektimin e substancave në trupin e tij apo jo, etj. Ankuesi pretendon se,

për këto dhe të tjera, ai kundërshton të gjitha kufizimet që organet e Shtetit Shqiptar kanë ndërmarrë nën justifikimin e një virusi.

Me dy e-maile dërguar në datë 28.09.2021, ankuesi ka dërguar sqarime dhe informacion shtesë në lidhje me ankesën, duke parashtruar se:

Në ankesën e depozituar ankuesi shprehet se, ka përmendur se është i interesuar që t'i kthehet studimeve për t'i mbyllur pasi ka nisur që në vitin 2012 studimet për nivelin master shkencor, pranë universitetit privat "Albanian University", por për arsye të ndryshme nuk ka patur mundësi t'i përfundoj dhe dëshironte që t'i rikthehej studimeve për t'i përfunduar. Sipas ankuesit, sigurimi i një vërtetimi, do të kishte kosto, pasi që universiteti t'i lëshojë vërtetim, do kërkojë pagesën e vitit të studimit. Ankuesi shprehet se, që të bëjë atë pagesë atij i duhet të ketë siguri që do mund t'i ndjek studimet pa kryer injektimin e të ashtuquajturës vaksinë dhe pa patur nevojë për të bërë PCR test çdo javë (60 Euro në javë). Ankuesi shprehet se, alternativa e studimeve online nuk është opsion për atë, pasi kur ka filluar programin e ka filluar për të ndjekur studimet me kohë të plotë dhe madje është penalizuar për mungesat në seminare apo leksione.

Për sa i përket kufizimeve të tjera, ankuesi pretendon se urdhri nr.373, i cili ka hyrë në fuqi nga 01 Shtator 2021, e privon atë nga e drejta e lëvizjes së lirë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pa vendim gjykate, pa bërë asnjë shkelje administrative, penale, pa u diagnostikuar me ndonjë sëmundje infektive etj.

Ankuesi ka plotësuar informacionin në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë duke dërguar kopje të urdhrit nr.413, datë 24.09.2021 *“Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit Covid-19 për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”*, miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja e vendimit për shpalljen e diskriminimit”*, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Ligji Nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, garanton mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: ***“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen***

ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, **gjendjen shëndetësore**, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, **ose me çdo shkak tjetër.**”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Bazuar në nenin 4, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.”

Bazuar në nenin 32, pika 1, gjerat “a” dhe “b” të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”; b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Bazuar në nenin 33, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para

komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.”

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;”

Bazuar në nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Bazuar në nenin 33, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative. 2. Në procedurën administrative janë gjithashtu palë edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative.”

- **Në lidhje me pretendimin e ankuesit se është diskriminuar në të drejtën për arsim.**

Bazuar në nenin 4, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, të marrë së bashku me nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, janë subjekte të ligjit dhe mund t’i drejtohen Komisionerit të gjithë personat fizikë dhe juridikë, si dhe çdo subjekt i së drejtës i parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Nenet 32/a dhe 33/1, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i njohin të drejtën çdo personi ose grupi personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose organizate me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive, për të paraqitur ankesë para Komisionerit. Këto dispozita të marra së bashku me nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, kërkojnë që pala e cila paraqet ankesën pranë Komisionerit, të ketë një interes legjitim të drejtëpërdrejtë në procedurën administrative, që kërkon të fillojë nëpërmjet paraqitjes së ankesës. Pra, në rastin konkret, që ankuesi të legjitimohen si palë në procedurën administrative para Komisionerit duhet që të kenë një interes legjitim të drejtëpërdrejtë.

Interesi është pikërisht dobia personale për të kërkuar përpara Komisionerit, njohjen ose rivendosjen e një të drejtë të mohuar ose të shkelur. Pra, e drejta e subjekteve që kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë Komisionerit është e lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tyre. Subjektet që ushtrojnë të drejtën për të bërë ankesë pranë Komisionerit, kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtëpërdrejtë midis

interesit ose të drejtës të pretenduar si të cënuar dhe veprimi ose mosveprimi që pretendohet si sjellje diskriminuese. Interesi duhet të jetë aktual, domethënë se dëmi që i shkaktohet ankuesit dhe që kërkohet të shmanget nëpërmjet ankesës , duhet që të ketë ndodhur në kohën e paraqitjes së ankesës ose të vërtetohet në një të ardhme shumë të afërt.

Ankuesi pretendon se, rregullimi që bëhet në urdhrin nr.413, datë 24.09.2021 “*Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit Covid-19 për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët*”, miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në vijim Urdhri nr.413, datë 24.09.2021, MSHMS) duke vendosur detyrimin për vaksinimin e detyruar të studentëve për ndjekjen e studimeve në auditoret e institucioneve të arsimit të lartë dhe ofrimi i studimit online, për studentët e pavaksinuar, e diskriminon atë duke cënuar dhe mohuar të drejtën për të ndjekur studimet. Ankuesi e legjitimon veten për paraqitjen e ankesës në lidhje me pretendimin për diskriminim në arsim, duke pretenduar se interesi i tij cenohet nga rregullimi i vendosur nga akti i mësipërm, pasi ai pikërisht në këto momente dëshiron që të vazhdojë të ndjekë studimet master të cilat shprehet se, i ka nisur që në vitin 2012 pranë universitetit privat "Albanian University", por për arsye të ndryshme nuk ka patur mundësi t'i përfundoj më parë.

Në pikën 2 dhe 4, të Urdhrin nr.413, datë 24.09.2021, të MSHMS përcaktohet: “2. *Personeli i institucioneve arsimore dhe studentët si një ndër kategoritë e përfshira në pikën 1, të këtij urdhri, duhet të depozitojnë pranë qendrës së punës dhe studentët pranë zyrave të përcaktuara nga IAL-të përkatëse, Certifikatën e Vaksinimit Covid-19 nga e-albania apo kartën e vaksinimit.....4 Për studentët që nuk paraqesin Certifikatën e Vaksinimit Covid-19 apo kartën e vaksinimit, drejtuesit e Institucioneve të Arsimit Universitar të marrin masa për ofrimin e studimit në platforma alternative online duke filluar nga data 11.10.2021.*”

Rezulton se, me urdhrin nr.413/1, datë 27.09.2021 “Për një ndryshim në urdhrin nr.413, datë 24.09.2021, “Për marrjen e masave, për parandalimin e infeksionit Covid-19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, të MSHMS, pika 4, e urdhrit të mësipërm ka ndryshuar si vijon : “*Studentët duhet të paraqesin certifikatën e vaksinimit Covid-19 apo kartën e vaksinimit, për të hyrë në institucionet e arsimit të lartë, duke filluar nga data 11.10.2021*”

Komisioneri vlerëson si të pabazuar, justifikimin e ankuesit për të mos paraqitur një vërtetim që do të provontë faktin se ai ishte student që do të ndiqte studimet për vitin akademik 2021-2022, me arsyetimin se, një gjë e tillë do të kishte kosto, pasi që universiteti t'i lëshojë vërtetim, do kërkojë pagesën e vitit të studimit dhe sipas ankuesit, që ai ta bëjë bëjë atë pagesë atij i duhet të ketë siguri që do mund t'i ndjek studimet pa kryer injektimin e të ashtuquajturës vaksinë dhe pa patur nevojë për të bërë PCR test çdo javë (60 Euro në javë).

Komisioneri vlerëson se, ankuesi duke patur detyrimin për të provuar interesin e tij personal, të drejtëpërdrejtë dhe aktual, dështoi të provojë se ka një lidhje të drejtëpërdrejtë midis pretendimit të tij për diskriminim në arsim dhe urdhrit nr.413, datë 24.09.2021, të MSHMS. Nga aktet e administruara nuk rezultoi e provuar që ankuesi në momentin e paraqitjes së ankesës të jetë

cënuar ose se do të çënohet në një të ardhme shumë të afërt, nga parashikimet e urdhrit nr.413, datë 24.09.2021, të MSHMS.

- **Në lidhje me pretendimin e ankuesit se masat shtrënguese të marra në kuadër të parandalimit të infeksionit Covid-19 janë diskriminuse.**

Përveç pretendimit për diskriminim në të drejtën për arsim, në ankesën e paraqitur, ankuesi pretendon se masat shtrënguese në përgjithësi që janë marrë nga “Qeveria Shqiptare” (sikurse referon vetë ankuesi) bien në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Në këtë kuadër ankuesi, pretendon se, këto masa çënojnë të gjitha të drejtat që një qytetarë i lirë ka, si, e drejta e arsimimit, lëvizjes së lirë, aksesit ndaj shërbimeve sociale, mjeksore, institucionale, e drejta e zgjedhjes për injektimin e substancave në trupin e tij apo jo, etj. Më tej në pretendimet e tij ankuesi pretendon se urdhri nr. 373, i cili ka hyrë në fuqi nga 01 Shtator 2021, e privon atë nga e drejta e lëvizjes së lirë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë pa vendim gjykatë, pa bërë asnjë shkelje administrative, penale, pa u diagnostikuar me ndonjë sëmundje infektive. Të gjitha pretendimet për çënimin e të drejtave të mësipërme, ankuesi gjithashtu i pretendon se përbëjnë diskriminim.

Referuar urdhrit nr.373, datë 30.08.2021 *“Për një ndryshim në urdhrin nr.99, datë 10.02.2021 “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”, të ndryshuar, të MSHMS, është parashikuar : “Kufizimin e lëvizjes së popullatës nga ora 23:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, nga data 01.09.2021 deri në masën 14.09.2021”*

Përgjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, rezulton se kufizimi i lëvizjes brenda vendit, ka qenë i ndryshëm në periudha kohore të ndryshme. Sikurse rezulton nga përcaktimi i mësipërm që bëhet në urdhrin nr.373/30.08.2021, të MSHMS, rezulton se kufizimi i vendosur me këtë akt ka qenë për një periudhë të caktuar kohore nga data 01.09.2021 deri në datën 14.09.2021. Rezulton gjithashtu së, në kohën e depozitimit të ankesës, efektet kufizuese të aktit të mësipërm kanë përfunduar.

Në lidhje me parashtrimin e fakteve dhe rrethanave të cilat sipas ankuesit përbëjnë diskriminimin e pretenduar, ai nuk jep informacion për situata kur ankuesi për të drejtat e pretenduara se i janë çënuar, të jetë prekur konkretisht.

Duke i qëndruar arsyetimit të bërë më sipër në lidhje me legjitimin e ankuesit për pretendimet e tij për diskriminim në arsim, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk arriti të provojë interesin e tij personal, të drejtëpërdrejtë dhe aktual, midis të drejtave që pretendon se i janë çënuar dhe atyre që ai referon në mënyrë të përgjithshme si masa shtrënguese të marra nga “Qeveria Shqiptare”. Në këtë kuadër, Komisioneri gjykon të theksojë se, asnjë person, ose grup personash, nuk mund në mënyrë abstrakte, të paraqesin një ankesë duke pretenduar se një akt, praktikë ose sjellje, konsiderohet të jetë në kundërshtim me Ligjin nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Një person ose një grup personash, mund të pretendojnë se janë viktima të diskriminimit, nëse ai/ajo ose ata, janë prekur në të vërtetë dhe konkretisht.

Bazuar në parashtrimin e fakteve dhe rrethanave ku ankuesi bazon pretendimet e tij për diskriminim, ky i fundit shprehet se masat e marra në kuadër të parandalimit të infeksionit Covid-19 çenojnë të drejtat dhe diskriminojnë të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë. Një pretendim i tillë theksohet nga ankuesi edhe kur ai shprehet në lidhje me masat që kërkon të merren nga Komisioneri, duke u shprehur se kërkimi i tij konsiston në marrjen e masave për mbrojtjen e të gjitha kategorive të pretenduara se janë cënuar nga masat e marra në kuadër të parandalimit të infeksionit Covid-19.

Komisioneri vlerëson se bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr.10221/2010 “ Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe nenin 33, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, legjitimohen për të qenë palë në procedurën administrative para Komisionerit edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen. Në këtë kuptim, për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave apo interesave publike në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit, legjislacioni në fuqi ka legjitimuar për të qenë palë në një procedurë administrative, mbajtësit e interesave publike/kolektivë, që mund të jenë organizata të ndryshme shoqërore të njohura me ligj dhe që kanë si qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut, komunitete fetare, sindikata, etj.

Në këtë kontekst, është praktikë e Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që kur shqetësimi apo diskriminimi i pretenduar nuk i adresohet personalisht një personi, por prek një komunitet në tërësi, pra cenon interesa kolektivë apo publikë, ankesa të formësohet nga një organizatë me interes të ligjshëm dhe jo nga çdo individ.²

Në kushtet kur ankuesi nuk arriti të provojnë se ka një interes të drejtëpërdrejtë, personal dhe aktual, ai nuk mund t’i drejtohen Komisionerit për të arritur respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave apo interesave publike që i drejtohen një komuniteti në tërësi apo një grupi shoqëror. Në këtë kontekst, për të bërë një ankesë para Komisionerit do të legjitimoheshin subjektet që janë mbajtës të interesave kolektive apo interesave të gjerë të publikut në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit.

² Vendimi Nr.62, datë 17/06/2020, Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Qendra për Advokim Social, Qendra për Aksion Komunitar dhe Qendrëa T’reja, kundër Deputetit të Kuvendit, z. M. M;

Vendimi Nr.63, datë 17/06/2020, Shoqata “Disutni Albania”, “Lëvizja për Mbrojtjen e të Drejtave Rome” dhe “Amare Roma”; kundër Deputetit të Kuvendit, z. M. M;

Vendimi Nr. 64, datë 17/06/2020 Shoqata “Rromano Kham”, kundër Deputetit të Kuvendit, M.M;

Vendimi Nr.15, datë 30/01/2019, Shoqata Ilinden, kundër Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”;

Vendimi Nr.36, datë 05/03/2019, Fondacioni Down Sindrome Albania kundër Bio Save Tirana;

Vendimi Nr.120, datë 09/09/2019, Fondacioni Down Sindrome Albania kundër Deputetit të Kuvendit, z. M.M.

Vendimi Nr.125, datë 01/08/2014, Shoqata “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT” dhe Shoqata “Të bashkuar pro kauzës LGBT”, kundër subjektit politik Aleanca Kuq e Zi.

Vendimi Nr.70, datë 13.07.2020 Dh.H, I.K, B.Ç, M.E dhe A.I, kundër M.K, Deputete në Kuvendin e Shqipërisë

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesi B.V nuk legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, nenin 33, pika 4, gërma “b” dhe nenin 33 pika 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar dhe Kodin e Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me Nr.167 Regjistri, datë 17.09.2021, të paraqitur nga ankuesi B.V kundër Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komitetit Teknik të Ekspertëve dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku : Gjendja shëndetësore dhe çdo shkak tjetër
Fusha : Arsim; Shërbime
Lloji i vendimit: Mospranim